



Në bazë të nenit 149 nga Ligji mbi Arsimin e Lartë (Gazeta Zyrtare e RM nr. 82/18), në bazë të nenit 130, 131 dhe 132 të Statutit të BAS, në bazë të nenit 9 të Rregullores mbi kushtet, kriteret, procedurës dhe rregullave për regjistrim dhe studim në ciklin e parë të studimeve, nenit 10 të Rregullores mbi kushtet, kriteret, procedurës dhe rregullave për regjistrim dhe studim në ciklin e dytë të studimeve

INSTITUCIONI PRIVAT JOFITIMPRURËS I ARSIMIT TË LARTË SHKOLLA E LARTË E PAVARUR PROFESIONALE
BIZNES AKADEMIJA SMILEVSKI – BAS
SHPALL
K O N K U R S

PËR REGJISTRIMIN E STUDENTËVE NË CIKLIN E PARË DHE TË DYTË TË STUDIMEVE NË VITIN STUDIMOR 2023/2024

I. NUMRI I STUDENTËVE

1) NUMRI I STUDENTËVE QË MUND TË REGJISTROHEN NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE NË BAS

MENAXHMENTIT TË BIZNESIT, program studimor trevjeçar i studimeve të ciklit të parë BAS - mund të regjistrohen gjithsej 85 studentë në selinë e BAS në Shkup dhe në njësinë për studime të disperzuara të BAS në Manastir.

MARKETING MENAXHMENT * - program studimor trevjeçar i studimeve të ciklit të parë BAS - mund të regjistrohen gjithsej 85 studentë në selinë e BAS në Shkup dhe në njësinë për studime të disperzuara të BAS në Manastir.

2) NUMRI I STUDENTËVE QË MUND TË REGJISTROHEN NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE NË BAS

Në programin studimor njëvjeçar të MENAXHMENTIT STRATEGJIK, në ciklin e dytë të studimeve në BAS, mund të regjistrohen gjithsej 42 studentë në selinë e BAS në Shkup dhe në Repartin e studimeve të disperzuara në BAS në Manastir

Në programin studimor njëvjeçar të MENAXHIMI STRATEGJIK I BURIMEVE NJERËZORE, në ciklin e dytë të studimeve në BAS, mund të regjistrohen gjithsej 42 studentë në selinë e BAS në Shkup dhe në Repartin e studimeve të disperzuara në BAS në Manastir

II. KUSHTET DHE KRITERET PËR REGJISTRIM NË BAS

1) KUSHTET DHE KRITERET PËR REGJISTRIM NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE (DERI DIPLOMIKE) NË BAS

A. Regjistrimi i studentëve të rregullt

Të drejtën e regjistrimit në ciklin e parë të studimeve e kanë kandidatët të cilët kanë kaluar maturë shtetërore ose ndërkombëtare.

Të drejtën e regjistrimit e kanë edhe kandidatët të cilët kanë përfunduar arsimim të mesëm katërvjeçar sipas rregulloreve të cilat ishin në fuqi para fillimit të aplikimit të maturës shtetërore, gjegjësisht para vitit 2007/2008.

Të drejtën e regjistrimit e kanë edhe kandidatët të cilët kanë përfunduar arsimim të mesëm jashtë shtetit, me pas nostrifikimit paraprak të diplomës nga Ministria e arsimit dhe shkencës në R. E Maqedonisë së Veriut.

Të drejtën e regjistrimit e kanë edhe kandidatët me diplomë për arsimim të mesëm të përfunduar (kandidatë të cilët kanë mbaruar në vitin shkollor 2019/2020).

Të drejtën e regjistrimit e kanë edhe studentët nga institucionet tjera të arsimit të lartë dhe persona të diplomuar, sipas procedurës së posaçme për transferimin e kredive, gjegjësisht pranimin e provimeve – kredive të dhëna paraprakisht.

Në ciklin e parë të studimeve në BAS mund të regjistrohen kandidatë të cilët janë shtetas të RMV dhe arsimimin e mesëm e kanë mbaruar në R. E Maqedonisë së Veriut ose në shtete tjera (me nostrifikim paraprak të kualifikimit arsimor).

Në ciklin e parë të studimeve në BAS mund të regjistrohen gjithashtu edhe kandidatë, shtetas të huaj, me zbatimin e parimit të reciprocitetit.

B. Regjistrimi i studentëve me korrespondencë

Të drejtën e regjistrimit në ciklin e parë të studimeve e kanë kandidatët të cilët nga shkaqe të arsyeshme nuk janë në mundësi të regjistrohen si studentë të rregullt për të cilin shkak parashtrohet dokumentacion përkatës në të cilin jepen arsyet për studim me korrespondencë. Si shkaqe të arsyeshme llogariten: angazhim pune, arsye shëndetësore të kandidatit ose shkaqe tjera të arsyeshme të bazuara në dokumentacion përkatës nga ana e studentit kurse të aprovuara nga ana e Komisionit.

Studentët me korrespondencë regjistrohen sipas kushteve dhe kriterëve të njëjta sikurse studentët e rregullt.

Studentët e regjistruar kanë mundësi që pjesërisht ose të gjithë programin studimor ta realizojnë nga largësia ose me sinergjim sipas Rregullores mbi kushtet, kriteret, procedurës dhe rregullave për studim me korrespondencë në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve në BAS.

C. Regjistrimi i studentëve në ciklin e parë të studimeve me transferim të kredive

Të drejtën e regjistrimit në ciklin e parë të studimeve në BAS e kanë edhe studentët nga institucionet tjera e arsimit të lartë si dhe persona të diplomuara, me procedurë të veçantë të transferimit të kredive, gjegjësisht me pranimin e provimeve të dhëna paraprakisht. Të drejtën e regjistrimit në ciklin e parë të studimeve në BAS e kanë edhe kandidatët - studentët të cilët kalojnë nga njëri në institucion tjetër të arsimit të lartë, gjegjësisht nga njërit në programet tjera studimore në të njëjtin ose nga një institucion tjetër të arsimit të lartë me procedurë për transferimin e kredive, gjegjësisht pranimin e provimeve të dhëna paraprakisht.

Të drejtën e regjistrimit në ciklin e parë të studimeve në BAS e kanë edhe kandidatët - studentët të cilët kalojnë nga njëri në institucion tjetër të arsimit të lartë, gjegjësisht nga njërit në programe tjera studimore në të njëjtin ose nga ndonjë institucion tjetër të arsimit të lartë nga mbyllja e parë e librit amzë deri në mbylljen e dytë të tij dhe gjatë kësaj ti shfrytëzojë përparësitë e sistemit të transferimit të kredive si dhe nën kushte tjera të parapara me Ligj dhe akte nënligjore.

Kushtet, procedura dhe mënyra e transferimit të ECTS kredive dhe kalimi nga njëri në ndonjë program tjetër studimor ose nga njëri në ndonjë institucion tjetër të arsimit të lartë janë përcaktuar në Rregulloren për sistemin e vetëm të transferimit të kredive dhe kalimin nga njëri në ndonjë program tjetër studimor, gjegjësisht nga njëra në institucion tjetër të arsimit të lartë në BAS.

Studentët me transferim të kredive nga institucionet tjera të arsimit të lartë regjistrohen sipas kushteve dhe kriterëve të njëjta si edhe studentët e rregullt.

Kur aplikojnë, kandidatët duhet të paraqesin dëshmi të arsimit të mëparshëm nga institucioni tjetër / institucionet tjera të arsimit të lartë (fletë shlahjmërim, vërtetim i provimeve të dhëna).

Pagesa për shkollim për kandidatët me transferim të kredive nga institucionet e tjera të arsimit të lartë reduktohet në raport me vlerën e kredive të pranuar (të bartura). Vlera e 1 ECTS është 22 euro në kundërvlerë me denarë.

D. Regjistrimi i studentëve shtetas të huaj

1. Në ciklin e parë të studimeve munden të regjistrohen studentë, shtetas të huaj, nën kushtet e përcaktuara me Ligj, Statut aktet tjera normative të BAS.

E. Dokumente për aplikim

1. Diplomë për maturë shtetërore ose maturë ndërkombëtare (origjinal ose kopje e noterizuar);
2. Dëftesat e të gjithë viteve të shkollës së mesme (origjinal ose kopje e noterizuar);
3. Shtojca e dëftesës për vitin e përfunduar të arsimit (vlen për kandidatët të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm katërvjeçar në vitin shkollor 2016/2017)
4. Diploma për përfundimin e arsimit të mesëm (vlen vetëm për kandidatët të cilët kanë përfunduar në vitin shkollor 2019/2020)
5. Ekstrakt nga Libri amzë i të lindurve (origjinal ose kopje e noterizuar);
6. Vërtetim mbi shtetësinë (origjinal ose kopje e noterizuar);
7. Fletëparaqitje e plotësuar për regjistrim në BAS (mund të gjendet në Internet faqen e BAS (<https://bas.edu.mk/di/PrijavaVtorCiklus.pdf>))
8. Vërtetim për provimet e dhëna ose fletëçlajmërimi nga institucioni i mëparshëm i arsimit të lartë (vlen vetëm për studentët të cilët regjistrohen me transferim të kredive nga institucionet tjera të arsimit të lartë)
9. Dëshmi për pengesën e ndjekjes së rregullt të mësimin (vlen vetëm për studentët të cilët regjistrohen me korrespondencë)
10. Dokumentet plotësuese për studentët shtetas të huaj (Vendim për qëndrim të përkohshëm në R. E Maqedonisë së Veriut e lëshuar nga Ministria e punëve të brendshme në RMV, Vendim për nostrifikimin e diplomës për përfundimin e arsimit të mesëm e lëshuar nga Ministria e arsimit dhe shkencës në RMV, diplomë për përfundimin e arsimit të mesëm (vulë Apostille në diplomë për shtetet nënshkruese të konventës së Hagës kurse për të tjerët, vulë nga Ministria e punëve të jashtme), dëftesa origjinale për secilin vit të përfunduar të arsimit të mesëm dhe përkthim i dëftesave nga një përkthyes i autorizuar gjyqësor me noterizim, origjinal i ekstraktit nga libri amzë i të lindurve dhe përkthim nga një përkthyes i autorizuar gjyqësor me noterizim, vërtetim mbi shtetësinë në origjinal dhe përkthim nga një përkthyes i autorizuar gjyqësor me noterizim, fotokopje e pasaportës së vlefshme e noterizuar, vërtetim mjekoligjor mbi gjendjen e përgjithshme dhe psikofizike shëndetësore të kandidatit e lëshuar nga person mjekësor e përkthyer në gjuhën maqedonase me noterizim të rregullt (Statusi HIV dhe HEPATITIS C) jo më i vjetër se 6 muaj, certifikatë /vërtetim / diplomë për njohjen e gjuhës maqedonase dhe dokumente tjera në rast nevojë ose sipas kërkesës të BAS varësisht nga specifika e rastit konkret). Dokumentet dorëzohen personalisht, në hapësirat ku do të realizohet programi studimor, gjegjësisht në selinë e BAS në Shkup në rr. Jane Sandanski Nr. 111/2 ose në Repartin e studimeve të disperzuara të BAS në Manastir në rr. Herceg Novi Nr. 6, çdo ditë nga e hëna e deri të premten prej orës 08:00 deri me 17:00.

F. Kohëzgjatja e studimeve:

Studimet e ciklit të parë janë në kohëzgjatje prej 3 (tre) viteve studimore, 6 (gjashtë) semestrave, përveç për kandidatët me transferim të kredive ku kohëzgjatja e studimeve varet nga numri i kredive të transferuara.

Pas përfundimit të ciklit të parë të studimeve dhe përfitimin e 180 ECTS të nevojshme, studenti përfiton diplomë për arsim të lartë me titull Menaxher biznesi i diplomuar ose në anglisht Bachelor of Business Management. Përveç diplomës së akredituar, kandidatët përfitojnë edhe shtojcën e diplomës (suplementin) me përshkrimin e lëndëve dhe arritjeve tjera të studentit gjatë studimeve.

Studimet e ciklit të parë të Programit studimor për Marketing menaxhment janë me kohëzgjatje prej 3 (tre) vite studimi, 6 (gjashtë) semestra, me përjashtim të kandidatëve me transfer të kredive, ku kohëzgjatja e studimit varet nga numri i kredive të transferuara.

Pas përfundimit të ciklit të parë të studimeve dhe marrjes së 180 krediteve ECTS të nevojshme, studenti fiton diplomë të arsimit të lartë me titull Marketing Manaxher i diplomuar ose në gjuhën angleze Bachelor of Marketing Management. Krahas diplomës së akredituar, kandidatët pajisen me shtesë të diplomës me përshkrim të lëndëve dhe arritjeve të tjera të studentit gjatë studimeve.

G. Vlera e pagesës për shkollim

Vlera e pagesës për shkollim në programin studimor e Biznes menaxhmentit në ciklin e parë të studimeve në BAS është 1400 euro në vit në kundërvlerë në denarë.

Vlera e pagesës për shkollim në programin studimor e Marketing menaxhment në ciklin e parë të studimeve në BAS është 1400 euro në vit, në kundërvlerë në denarë.

Pagesa mund të bëhet me këste (deri në 12 këste mujore gjatë vitit).

Nën kushte të caktuara dhe për kategori të caktuara të studentëve BAS siguron edhe lehtësime në aspektin e shumës dhe mënyrës së pagesës të shkollimit. Në vlerën e pagesës së shkollimit përfshihen shpenzimet e pashmangshme për studim si që janë shpenzimet për mësim mbajtje, literatura bazë dhe plotësuese, mjetet mësimore, materiale tjera, paraqitja e provimeve, certifikimi i semestrit, shfrytëzimi i bibliotekës, administrimi i dokumenteve (indeks, legjitimacion i studentit, vërtetime, certifikata etj.) etj.

2) KUSHTET DHE KRITERET PËR REGJISTRIM NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE (STUDIME POSTDIPLOMIKE) NË BAS

A. Kushtet dhe kriteret për regjistrim në ciklin e dytë të studimeve (studime postdiplomike)

Të drejtën e regjistrimit në ciklin e dytë të studimeve e kanë kandidatët të cilët kanë përfunduar programe përkatëse studimore nga cikli i parë i studimeve profesionale ose akademike, gjegjësisht kandidatët të cilët kanë përfunduar studime trevjeçare në ciklin e parë dhe kanë përfituar 180 ECTS dhe kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet në ciklin e parë të studimeve dhe kanë përfituar 240 ECTS.

Të drejtën e regjistrimi në ciklin e dytë të studimeve e kanë edhe kandidatët të cilët kanë përfunduar studime joadekuate të ciklit të parë në të cilin rast, për regjistrim përcaktohet vizita e kursit përgatitor i përcaktuar me vetë programin studimor.

Në ciklin e dytë të studimeve në BAS mund të regjistrohen kandidatët të cilët janë shtetas të R. të Maqedonisë së Veriut dhe të cilët arsimin e kanë kryer në R. E Maqedonisë së Veriut; kandidatët të cilët janë shtetas të R. të Maqedonisë së Veriut dhe të cilët arsimin e kanë kryer në shtetet e huaja (me nostrifikim paraprak të kualifikimit arsimor); kandidatët – shtetas të huaj me arsim të lartë të kryer në institucionet e arsimit të lartë në R. E Maqedonisë së Veriut ose në shtetet e huaja (me nostrifikim paraprak të kualifikimit arsimor).

Në ciklin e dytë të studimeve në BAS mund të regjistrohen edhe kandidatët shtetas të huaj, me zbatimin e parimit të reciprocitetit.

Studentët e regjistruar në ciklin e dytë të studimeve në BAS kanë mundësi që pjesërisht ose të gjithë programin studimor ta realizojnë me korrespondencë ose nëpërmjet të sinergjimit në përputhje me Rregulloren mbi kushtet, kriteret, procedurës dhe rregullave për studim me korrespondencë në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve në BAS.

B. Regjistrimi i studentëve në ciklin e dytë të studimeve me transferim të kredive

Të drejtën e regjistrimit në ciklin e dytë të studimeve në BAS e kanë studentët nga institucionet tjera të arsimit të lartë si edhe persona të diplomuara, me procedurë të posaçme të transferimit të kredive gjegjësisht pranimin e provimeve të dhëna më parë. Të drejtën e regjistrimit në ciklin e dytë të studimeve në BAS e kanë edhe kandidatët - studentët të cilët kalojnë nga njëri në institucion tjetër të arsimit të lartë, me procedurë të posaçme të transferimit të kredive gjegjësisht pranimin e provimeve të dhëna më parë.

Të drejtën e regjistrimit në ciklin e dytë të studimeve në BAS e kanë edhe kandidatët - studentët të cilët kalojnë nga njëri në institucion tjetër të arsimit të lartë gjegjësisht nga njëri në program tjetër studimor në të njëjtin ose nga një institucion tjetër të arsimit të lartë, prej mbylljes të parë të librit amzë e deri në mbylljen e dytë të tij dhe gjatë kësaj të shfrytëzojë përparësitë e sistemit të transferimit të kredive, si edhe nën kushte tjera të parapara me Ligj dhe akte nënligjore.

Kushtet, procedura dhe mënyra e transferimit të ECTS kredive dhe kalimi nga njëri në ndonjë program tjetër studimor ose nga njëri në ndonjë institucion tjetër të arsimit të lartë janë përcaktuar në Rregulloren për sistemin e vetëm të transferimit të kredive dhe kalimin nga njëri në ndonjë program tjetër studimor, gjegjësisht nga njëra në institucion tjetër të arsimit të lartë në BAS.

Studentët me transferim të kredive nga institucionet tjera të arsimit të lartë regjistrohen sipas kushteve dhe kriterëve të njëjta të përcaktuara në kushtet dhe kriteret për regjistrim në ciklin e dytë të studimeve.

Gjatë aplikimit, kandidatët duhet të paraqesin dëshmi të arsimit të mëparshëm të filluar në ndonjë institucion tjetër / institucione tjera të arsimit të lartë (fletë shblajmërim, vërtetim i provimeve të dhëna).

Pagesa për shkollim për kandidatët me transferim të kredive nga institucionet e tjera të arsimit të lartë reduktohet në raport me vlerën e kredive të pranuar (të bartura).

C. Dokumente për aplikim

1. Diplomë për përfundimin e ciklit të parë të studimeve profesionale ose akademike si edhe dokumente për arritjet pas diplomimit (origjinal ose kopje e noterizuar);
2. Ekstrakt nga Libri amzë i të lindurve (origjinal ose kopje e noterizuar);
3. Vërtetim mbi shtetësinë (origjinal ose kopje e noterizuar);
4. Fletëparaqitje e plotësuar për regjistrim në BAS (mund të gjendet në Internet faqen e BAS (<http://bas.edu.mk/dl/PrijavaVtorCiklus.pdf>))
5. Vërtetim për provimet e dhëna ose fletëçlajmërimi nga institucioni i mëparshëm i arsimit të lartë (vlen vetëm për studentët të cilët regjistrohen me transferim të kredive nga institucionet tjera të arsimit të lartë)
6. Dëshmi për pengesën e ndjekjes së rregullt të mësimin (vlen vetëm për studentët të cilët regjistrohen me qëllim të studimit me korrespondencë)
7. Dokumentet plotësuese për studentët shtetas të huaj (Vendim për qëndrim të përkohshëm në R. E Maqedonisë së Veriut e lëshuar nga Ministria e punëve të brendshme në RMV, Vendim për nostrifikimin e diplomës për përfundimin e arsimit të lartë (Cikli i parë i studimeve) e lëshuar nga Ministria e arsimit dhe shkencës në RMV, Diplomë origjinale për përfundimin e arsimit të lartë – ciklin e parë të studimeve me vulë Apostille në diplomë për shtetet nënshkruese të konventës së Hagës kurse për të tjerët, vulë nga Ministria e punëve të jashtme, përkthim i diplomës nga një përkthyes i autorizuar gjyqësor me noterizim, origjinal i ekstraktit nga libri amzë i të lindurve dhe përkthim nga një përkthyes i autorizuar gjyqësor me noterizim, vërtetim mbi shtetësinë në origjinal dhe përkthim nga një përkthyes i autorizuar gjyqësor me noterizim, fotokopje e pasaportës së vlefshme e noterizuar, vërtetim mjekoligjor mbi gjendjen e përgjithshme dhe psikofizike shëndetësore të kandidatit e lëshuar nga person mjekësor e përkthyer në gjuhën maqedonase me noterizim të rregullt (Statusi HIV dhe HEPATITIS C) jo më i vjetër se 6 muaj, certifikatë

/vërtetim / diplomë për njohjen e gjuhës maqedonase dhe dokumente tjera në rast nevojë ose sipas kërkesës të BAS varësisht nga specifika e rastit konkret).

Dokumentet dorëzohen personalisht, në hapësirat ku do të realizohet programi studimor, gjegjësisht në selinë e BAS në Shkup në rr. Jane Sandanski Nr. 111/2 ose në Repartin e studimeve të disperzuara të BAS në Manastir në rr. Herceg Novi Nr. 6, çdo ditë nga e hëna e deri të premten prej orës 08:00 deri me 17:00.

D. Kohëzgjatja e studimeve:

1. Studimet e ciklit të dytë janë në kohëzgjatje prej 1 (një) viti studimor, 2 (dy) semestra, përveç për kandidatët me transferim të kredive ku kohëzgjatja e studimeve varet nga numri i kredive të transferuara.

Pas përfundimit të ciklit të dytë të studimeve dhe përfitimin e 60 EKTS të nevojshme, studenti përfiton diplomë për arsim të lartë me titull Specialist në menaxhmentin strategjik ose në anglisht Specialist in Strategic Management.

2. Studimet e ciklit të dytë janë në kohëzgjatje prej 1 (një) viti studimor, 2 (dy) semestra, përveç për kandidatët me transferim të kredive ku kohëzgjatja e studimeve varet nga numri i kredive të transferuara.

Pas përfundimit të ciklit të dytë të studimeve dhe përfitimin e 60 EKTS të nevojshme, studenti përfiton diplomë për arsim të lartë me titull Specialist në MENAXHIMI STRATEGJIK I BURIMEVE NJERËZORE ose në anglisht Specialist in MENAXHIMI STRATEGJIK I BURIMEVE NJERËZORE

E. Vlera e pagesës për shkollim

Vlera e pagesës për shkollim në programin studimor e menaxhmentit strategjik në ciklin e dytë të studimeve në BAS është 1500 Euro në kundërvlerë në denarë. Paga mund të bëhet në këste (deri në 12 këste mujore gjatë vitit). Nën kushte të caktuara dhe për kategori të caktuara të studentëve BAS siguron edhe lehtësime në aspektin e shumës dhe mënyrës së pagesës të shkollimit. Në vlerën e pagesës së shkollimit përfshihen shpenzimet e pashmangshme për studim si që janë shpenzimet për mësim mbajtje, vlerësimi dhe mbrojtja e punës së specializimit, literatura bazë dhe plotësuese, mjetet mësimore, materiale tjera, paraqitja e provimeve, certifikimi i semestrit, shfrytëzimi i bibliotekës, administrimi i dokumenteve (indeks, legjitimacion i studentit, vërtetime, certifikata etj.) etj.

III. AFATET E APLIKIMIT DHE REGJISTRIMIT

AFATE PËR APLIKIM DHE REGJISTRIM	CIKLI I PARË I STUDIMEVE			CIKLI I DYTË I STUDIMEVE	
	Afati i parë i aplikimit	Afati i dytë i aplikimit	Afati i tretë i aplikimit	Afati i parë i aplikimit	Afati i dytë i aplikimit
Aplikimi i kandidatëve	Nga shpallja e konkursit deri më 18.08.2023	30.08 - 07.09.2023	18.09 - 22.09.2023	Nga shpallja e konkursit deri më 01.09.2023	11.09.2023 – 25.10.2023
Regjistrimi i studentëve	24 dhe 25 gusht 2023	14 dhe 15 shtator 2023	29 shtator 2023	07 shtator 2023	30 tetor 2023

Mësimdhënia në programet studimore në BAS zhvillohet në gjuhën maqedonase. Për disa lëndë, BAS ka siguruar “dritare mobiliteti” për të cilat mësimdhënia zhvillohet në gjuhën angleze.

BAS e përcakton procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për regjistrim në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve në BAS në mënyrën e cila garanton barazinë e të gjithë kandidatëve pavarësisht nga raca, ngjyra e lëkurës, seksi, gjinia, gjuha, feja, bindjet politike ose tjera, origjina etnike , kombëtare ose shoqërore, prona, lindja, statusi shoqëror, invaliditeti, orientimi seksual dhe mosha.

Kriteret mbi bazën e të cilave do të kryhet seleksionimi dhe përzgjedhja e kandidatëve për regjistrim në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve në BAS janë të përcaktuara në Rregulloren për kushtet, kriteret, procedurën dhe rregullat për regjistrim dhe studim në ciklin e parë të studimeve dhe Rregulloren për kushtet dhe kriteret, procedurat dhe rregullat për regjistrim dhe studim në ciklin e dytë të studimeve, të cilat mund të gjenden në faqen e internetit të BAS.

Studentët të cilët studiojnë në të njëjtën kohë në disa programe studimore të specialiteteve të ndryshme dhe studiojnë kurse shtesë, si edhe studentët të cilët përparojnë më shpejt në studime, studentët të cilët i vazhdojnë studimet në një institucion tjetër të arsimit të lartë në rast se institucioni i arsimit të lartë në të cilin kanë qenë të regjistruar e ndërprejnë punën, studentët të cilët kalojnë nga njëri në ndonjë tjetër institucion i arsimit të lartë, gjegjësisht nga njëra në programe dhe drejtime tjera studimore ose në të njëjtin institucion të arsimit të lartë dhe në të njëjtën kohë i shfrytëzojnë përfitimet e sistemit të transferimit të kredive, studentët të cilët i vazhdojnë studimet e ndërprera nën kushte të përcaktuara me Statutin e institucionit të arsimit të lartë, studentët e huaj si dhe studentët tjerë të cilët për arsye të justifikuar nuk janë regjistruar në librin amzë gjatë afatit të parë të mbylljes së librit amzë të studentëve të regjistruar dhe nëse ka vende të paplotësuara konform këtij konkursi dhe studentëve të regjistruar në mbylljen e parë të librit amzë, këtë mund ta bëjnë deri në mbylljen e dytë të librit amzë, me atë që do të paraqiten më së voni deri më 1 shkurt 2024. Si arsye të justifikuar nga të cilat ndonjë student nuk ka mund të regjistrohet në librin amzë në afatin e parë të mbylljes konsiderohen: sëmundja, për të cilën studentit paraqet listë lëshimi nga trajtimi spitalor për periudhën e afatit të kohëzgjatjes së regjistrimit; vdekje e një anëtar i familjes të ngushtë, për të cilën gjë studentit paraqet një ekstrakt nga libri amzë i të vdekurve; procedura e papërfunduar për nostrifikimin e certifikatave dhe diplomave të përfituara në shtetet e huaja. Regjistrimi i këtyre studentëve bëhet në përputhje me Rregulloren për formën dhe mënyrën e mbajtjes (në formë materiale dhe elektronike) dhe përmbajtjes së librit amzë të studentëve të regjistruar dhe librit kryesor të studentëve të diplomuar (Gazeta Zyrtare e RSM nr. 102/18 dhe 245/18), kurse pas pëlqimit paraprak me shkrim nga ana e Ministrisë përgjegjëse për çështjet e arsimit të lartë.

BAS mban të drejtën të rregullojë afatet dhe të drejtën për t'u regjistruar në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, në përputhje me ndryshimet e dhëna nga organet kompetente.

*Programi studimor në Menaxhimin Strategjik të Resurseve Njerëzore është në proces të marrjes së Vendimit për akreditim të programit studimor nga Bordi për Akreditim të Arsimit të Lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

E RËNDËSISHME: Për ata studentë që do të aplikojnë jo më vonë se 30 qershor 2023, ka një zbritje prej 10% të shumës totale të studimit.

Më shumë informata në www.bas.edu.mk, info@bas.edu.mk ose në 02/2455-754, 047/225-218